REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

U R DH Ë R

Nr. 191, datë 16.10.2025

PËR

EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË BORDIT TË AKREDITIMIT PRANË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të pikës 15, të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit,

U R DH Ë R O J:

1. Emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit të Akreditimit pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si më poshtë vijon:

a)	Znj. Shqiponja Telhaj	kryetar;
b)	Z. *Tomas Jelenski*	anëtar;
c)	Z. *Maurice Oudejans*	anëtar;
ç)	Z. Iraj Hashi	anëtar;
d)	Z. Indrit Hoxha	anëtar;
dh)	Znj. Darinka Piqani	anëtar;
e)	Z. Dritan Naçe	anëtar;
ë)	Znj. Mirjeta Beqiri	anëtar;
f)	Z. Nikolla Qafoku	anëtar;
g)	Z. Kita Sallabanda Diaz	anëtar;
gj)	Znj. Loreta Kondili	anëtar.

2. Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Bordit të Akreditimit, si dhe shpërblimi i tyre të përcaktohen sipas parashikimeve të vendimit nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", të ndryshuar.

3. Urdhri nr.63, datë 27.7.2021, i Kryeministrit, "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë", shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

NR.PROT. 481611
DATË 16.10 .2025

MINISTRISË SË ARSIMIT
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE